

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **palës ankuese;**

S. N. B. nga ...,

Kundër:

M. P. , me vendbanim në, J., Š., 14226 ..., R. e Serbisë

Palë kërkuese në AKP/tani palë përgjegjëse në ankesë/,

Duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/203/2013, të datës 11 Qershor 2013, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave, me numër KPA50626, sipas kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë M. P.), në seancën e mbajtur me datë, 26 Nëntor 2020, merr;

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga S. N. B., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/203/2013, të datës 11 Qershor 2013, për sa i përket kërkesës e regjistruar në AKP, me numër KPA50626, hedhet si e pas afatshme.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Më datë 23 Nëntor 2007, M. P., (tutje; pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (tutje AKP), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare,(ABF), të bartësit të drejtës pronësore (BDP), në emër të babait të saj të ndjerë S. J., me të cilën kërkon ti konfirmohet e drejta e shfrytëzimit dhe ri posedimi i ngastrës kadastrale, nr...., në sipërfaqe prej 00.32.89ha, me kulturë pemishte, e klasës së dytë, e cilat ndodhet në vendin e quajtur, "...-do druma", Zona Kadastrale, ..., Komuna ..., e regjistruar në Fletën Poseduese nr.,(tutje prona e kërkuar).
2. Në kërkesë kishte shënuar se, pronar ligjor i pronës së kërkuar është babai i saj i ndjerë, po ashtu thekson se humbja e posedimit të kësaj prone kishte ndodhur me datë 14 qershor 1999, si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99, e cila pastaj ishte uzurpuar në mënyrë të pa ligjshme nga NN persona.

3. Në mbështetje të kërkesës në AKP *inter alia*, kishte dorëzuar dokumentet si në vijim;
- Kopjen e Fletës Poseduese nr. ..., të datës 20.05.2003, sipas së cilës pronar i ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 00.32.89 ha, me kulturë pemishte e klasës së dytë, e cila ndodhet në vendin e quajtur “ M. ...”, Zona kad. ..., është J. P. S.o, me 1/1 pjesë ideale të pronësisë.
 - Vendimin e trashëgimisë nr.8/59,viti 1959, në bazë të cilit BDP, babai i palës përgjegjëse në ankesë ishte shpallur trashëgimtarë i pronës lëndore dhe pronave tjera të kërkuara me kërkesa tjera në AKP,(me që pronat në kadastër ishin në emër të BDP, nga AKP nuk ishte bërë verifikimi i këtij vendimi).
 - Certifikatën e lindjes me nr. ..., të dt. 22.10.2002, në emër të saj nga e cila dëshmohet lidhja familjare me BDP të pronës lëndore.
 - Certifikatën nga libri amë i të kurorëzuarve nr. ...,22.10.2002, po ashtu në emër të saj nga e cila dëshmohet se ka lidhur kurorë me datë 06.10.1966.
 - Certifikatë nga libri amë i të vdekurve, nr. ...,dt.21.10.2002,nga e cila dëshmohet se bashkëshorti i saj Ž. P. ka vdekur me datë 16 tetor 2002.
 - Certifikatë të vdekjes, nr. ...,dt.14.09.2009,nga e cila dëshmohet se BDP të pronës lëndore S. J. ka vdekur me datë, 12.06.1996.
 - Letërnjoftimin në emër të saj, me nr. pers.
4. AKP me datë 05.09.2008, kishte bërë njoftimin e kërkesës për pronën lëndore, e njëjta në kohën e vizitës është gjetur të jetë pemishte e pa uzurpuar nga askush. Me datë 17 qershor 2010, është bërë ri notifikimi dhe konfirmimit për mes publikimit në Gazetën nr. 2, dhe Buletinin e UNHCR.
5. N. B.me datë 23 mars 2012, ishte paraqitur në AKP, ku kishte kërkuar të drejtë ligjore për pronën lëndore, ai e kishte nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë si palë ,(tutje PP), në kërkesën e palës kërkuese, (tani përgjegjëse në ankesë). I njëjti kishte deklaruar se prona është e tij dhe e paraardhësve të tij të cilët në vitin 1934 ishin dëbuar nga prona e tyre nga pushteti i atëhershëm u ishte ndarë kolonistëve serbo malazez e konkretisht prona e tyre familjes së P. J. . Ai po ashtu kishte deklaruar se në vitin 1941 familja e tij ishin kthyer në pronën e tyre por në vitin 1946, prapë janë detyruar ta braktisin dhe janë dëbuar për në Shqipëri.
6. Në mbështetje të pretendimeve të tij PP N. B. në AKP kishte paraqitur;
- Aktgjykimin nr.49 , të dt. 31.12.1946,sipas së cilit familjes së BDP i është njohur e drejta pronësore në tokën e ndarë nga autoritet agrare.

- Deklaratën e dt. 24.12.2008 sipas së cilës pala përgjegjëse N. B. pohon se prona e kërkuar ishte e tyre para luftës së dytë botërore, (deklaratën e njëjtë të tij e kishin nënshkruar 51 dëshmitarë).
 - Regjistrin e emigrantëve të Kosovës të shpërngulur në Shqipëri përfshirë edhe PP.
 - Vendimin e organit të vitit 1946, (i mungojnë tri faqet e para),lidhur me rishikimin e vendimeve për ndarjen e tokës kolonistëve serb dhe malazez para vitit 1941.
 - Letërnjoftimin në emër të tij me nr. personal
7. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së, të dt. 04.04.2013, dokumentet personale të paraqitura nga pala kërkuese në AKP, edhe ato pronësore lidhur me pronën lëndore, edhe *ex officio*, ishin verifikuar pozitivisht si ekzistuese. Në Departamentin e kadastrit në ... me dt. 21.05.2008, ishte verifikuar pozitivisht Fleta Poseduese nr. ..., sipas certifikatës së të drejtave pronësore CDP me nr., për ngastrën kadastrale lëndore me numër ..., e cila ishte e evidentuar në emër të pronarit J. S.. (P.), me 1/1, pjesë ideale. Pra në bazë të këtyre dokumenteve të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë prej pas luftës së dytë botërore prona e evidentohet në emër të familjarëve të BDP të pohuar.
8. Më datë 11 qershor 2013, KKPK me vendimin e vet grupor KPCC/D/A/203/2013, që aplikohet edhe për kërkesën lëndore KPA50626, për ngastrën kad. ..., në sip. prej 00.32.89ha, kishte vendosur që, pala kërkuese e kishte dëshmuar se S. J. ka të drejtën e shfrytëzimit mbi 1/1 të pronës së kërkuar, dhe M. P. ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë, ndërsa çdo person që e ka uzurpuar pronën duhet ta liroj brenda afatit prej 30 ditë. Arsytimi epet në paragrafët (paragrafët 45-47), në vendimin grupor për kërkesën lëndore dhe kërkesën tjetër të saj ..., ku ndër të tjera theksohet se, pala kërkuese e ka dëshmuar të drejtën pronësore të BDP babait të saj S. J. në bazë të fletës poseduese të vitit 2003, e cila është verifikuar *ex officio* pozitivisht nga sekretaria, gjer sa pala përgjegjëse N. B. nuk kishte paraqitur mbrojtje juridike të vlefshme sipas pretendimeve të tij. A kishte paraqitur një vendim të viti 1946 që tregon se autoritetet e asaj kohe ja ndanë pronën P. J., paraardhës i palës kërkuese. Ai ofroi edhe deklaratë të dëshmitarëve të cilët konfirmojnë se pronat e kërkuara i kanë takuar familjes së tij para luftës së dytë botërore. Komisioni vlerësoi se në mungesë të dokumenteve dëshmuese deklaratat e dëshmitarëve nuk mund të konsiderohen dëshmi e mjaftueshme për të provuar të drejtën e përhershme të shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Po ashtu komisioni gjen se nuk ka mandat për shqyrtimin e akteve ligjore të shpronësimit nga regjimet e më parshme ,andaj vlerëson se në mungesë të mbrojtjes së vlefshme ligjore nga pala përgjegjëse N. B., komisioni konstaton se kërkesa e palës kërkuese duhet të miratohet.

9. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë (palë kërkuese në AKP) M. P. më 11 shtator 2013. Me datë 31 Tetor 2013, pala përgjegjëse në kërkesë N. B. ka refuzuar të pranoi Vendimin e KKPK-së.
10. Me datë 11.09.2013 pala përgjegjëse në ankesë kishte bërë kërkesë që prona të vihej nën administrimin e AKP, e cila pronë me vendimin e dt. 23.01.2014 ishte vendosur në administrim. Gjer sa me kërkesën e saj të dt. 11.09.2018, kishte kërkuar ri posedimin e pronës lëndore.
11. Megjithatë me datë 14.03.2019, djalit të palës përgjegjëse, S. B. nga AKP, lidhur me lëndën në shqyrtim KPA50626, i ishte dorëzuar Vendimi i KKPK-së, (provë fletë dorëzimi në shkresa të lëndës, faqe 149). Pala ankuese kundër këtij vendimi me datë 16.04.2019, kishte ushtruar ankesë.
12. Ankesa e palës ankuese i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë, me datë 29 maj 2019. Ajo ka paraqitur përgjigje në ankesë me 27 qershor 2019, për mes të djalit të saj D. P.. Përgjigjes i bashkëngjit certifikatën e lindjes së tij.

Pretendimet e palëve;

13. **Pala ankuese,** Vendimin e KKPK-së e atakon për shkak të vërtetimit jo të drejtë dhe të gabuar të gjendjes faktike andaj propozon që, gjykata pasi të shqyrtoi ankesën ti mundësoj shfrytëzimin e pronës lëndore sepse është e tij.
14. Në arsyetim ndër të tjera thekson se; familja e tij nga pushteti i atëhershëm janë dëbuar nga Kosova si të pa përshtatshëm, ndërsa pronat e tyre u ishin ndarë kolonistëve serb dhe ate Pero Jablan i ardhur nga Mali i Zi, pasi ishin kthyer ,përsëri janë dëbuar në vitin 1947, ndërsa pas vitit 1999, familja e tij është kthyer në pronat e tyre, të cilat legjitimisht janë të tyre sepse asnjëherë nuk u ishin kompensuar apo shpronësuar më parë, andaj për këtë kanë ushtruar padi në gjykatë kompetente për vërtetim pronësie, po ashtu thekson se edhe pse pronat ishin shfrytëzuar në mënyrë jo ligjore, me familjen e Pero Jablan janë të gatshëm të arrin marrëveshje me një çmim të arsyeshëm, etj.
15. Pala ankuese ankesës i bashkëngjit ;
 - Letërnjoftimin e tij, lëshuar me datë 10.02.2016 nga MPB/MUP/MIA/Kosovë, me nr. pers.
 - Aktvendimin nr. ..., të dt. 31.12.1946, të Komisionit A. të revizionit për , (citim “...”),sipas së cilit P. J. nga D., Komuna i njohët e drejta në tokën e ndarë të më hershme nga organet agrare në sipërfaqe prej 06.8 ha.

- Deklaratën në emër të N. R. B. të dt. 24.12.2008, e nënshkruar edhe nga 51 dëshmitar.(Dy dëshmitë e fundit ishin të paraqitura edhe në AKP të cekura si më lartë në këtë aktgjykim).

16. **Pala përgjegjëse** në përgjigjen e saj thekson se, kjo është çështje e gjykuar, sepse pala ankuese dhe babai i tij, tri here kanë ushtruar ankesa të cilat janë refuzuar, andaj kemi të bëjmë me vendim të plotfuqishëm, se prona e tyre ka qenë nën administrim të AKP-së, deri sa kanë bërë kërkesë për kthimin e posedimit dhe dëbimin e uzurpueseve, se prona është e trashëguar nga babai i tyre S. J.. Propozon që ankesa të hedhet poshtë si e pa lejuar, ose e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës,

17. Edhe pse, pala përgjegjëse në kërkesën e palës kërkuese në AKP, N. B.j, ka qenë palë gjatë procedurës në shkallën e parë, sipas konstatimit në fletëdorëzimin në shkresa të lëndës, rezulton se ai ka refuzuar ta pranoi vendimin e KKPK-së dhe nënshkrimin e fletë dërgesës për pranimin e vendimit me 31 tetor 2013.
18. Gjykata Supreme konsideron se tentimi i dorëzimit të vendimit të KKPK-së, palës përgjegjëse në kërkesë, me datë 31 tetor 2013, nuk ka qenë i rregullt ashtu si përcaktohet, sipas nenit 112, të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore,(i zbatueshëm si në kuptim të nenit 12.2 të Rreg.2006/50), ku parashihet se,“*Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, **dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa.** Nëse përmbushën kushtet “komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”.*
19. Po ashtu nuk mund të vlerësohet se dorëzimi është bërë edhe si në kuptim të nenit 6.3 në lidhje me nenin 6.5 (b), të Urdhërësës Administrative 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079,ku parashihet se: “*Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës sigurohet që dërgesa të bëhet në adresën për kryerjen e dërgesave të asaj pale, qoftë duke e dërguar kopjen e dokumentit përmes postës zyrtare, e cila jep vërtetimin, apo përmes dorëzimit personal të kopjes, për të cilin po ashtu merret vërtetimi për dorëzimin e dokumentit. Në rast të dërgimit personal të dokumentit,*

nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit apo nënshkrimin e vërtetimit për pranim, në ditën kur shërbimi është tentuar të kryhet, personi që e dorëzon dokumentin e shënon se dokumenti nuk është pranuar dhe kthehet në Sekretarinë Ekzekutive”.

20. Nga provat në shkresa të lëndës ,(fletë dorëzimi në faqe 141), nuk provohet se Vendimi i KKKP-së, i është lënë në adresën e tij dhe në fletë dërgesë nuk ceket dita ora dhe as shkaku i refuzimit, apo vendi ku i është lënë vendimi , po ashtu fletë dorëzimi nuk është i nënshkruar nga personi i cili ka tentuar të bëjë dorëzimin e vendimit, palës përgjegjëse.
21. Nga shkresat e lëndës, (fletë dorëzimi faqe 149 në lëndë), provohet se me datë 14.03.2019, vendim i KKKP lidhur me lëndën në shqyrtim KPA50626, i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë ,përkatësisht djalit të tij S.B., edhe pse ka të bëjë me dëbim, megjithatë i jepet e drejta në ankesë kundër vendimit të KKP-së, si në pjesën e parë të Fletëdorëzimit, ashtu edhe në pjesën e dytë,(nën nënshkrim të palëve) dhe atë në fjalinë e fundit të fletë dorëzimit, figuron se, “ ju njoftojmë se brenda 30 dite mund të ushtrohet ankesë në Gjykatë Supreme kundër vendimit të Komisionit ...”. Po ashtu sekretaria ankesën e palës ankuese si të tillë ia dërgon palës përgjegjëse për paraqitjen e përgjigjes në ankesë. Kolegji nga shkaqet e cekura si më lartë me që dorëzimi i parë ishte jo në rregull dhe sipas pretendimeve në ankesë kontestohet vendimi i KKP-së si tërësi, ankesën e palës ankuese e pranon si të lejueshme.

Afatshmëria e ankesës;

22. Kolegji pasi shqyrtoi afatshmërinë e ankesës megjithatë gjen se, ankesa e palës ankuese është paraqitur , pas afatit të lejuar ligjor. Neni 12.1, i Ligjit nr. 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”), përcakton si në vijim: “**Brenda tridhjetë (30) ditëve** nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.
23. Nga shkresat e lëndës përkatësisht sipas fletëdorëzimit dëshmohet se, pala ankuese e ka pranuar personalisht Vendimin e KKKP-së , më datë 14 Mars 2019, kurse ankesën kundër tij e ka paraqitur me datë 16 Prill 2019, (e protokolluar me vulë pranimi në AKP, PE-RO). Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj 30 ditë nga dita e pranimi të Vendimit të KKKP-së.
24. Afati për ankesë ka qen gjer me datë 13 Prill 2019, me që sipas kalendarit ishte ditë e Shtune,(jo ditë pune), ankesën ka mundur ta paraqes gjer me datë 15 Prill e hënë, (ditë

pune ,) ndërsa pala ankuese ankesën e ka paraqitur me datë 16 Prill, pra një ditë pas afatit të lejuar me ligj.

25. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë në përputhje me nenin 110.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, gjithashtu gjykata nuk ka gjetur arsye të justifikueshme për vonesën në shkresat e lëndës.
26. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e pas afatshme, në bazë të arsyeve procedurale të Ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtoj arsyet e ankesës.
27. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore ;

28. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-002-2019, me datë 26 Nëntor 2020

**Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani**